

Dt. 03.06.2020

Shtojcë:

Për shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:
“Ndërtimi i Godinës së Re të Ujësllësit”

Të nderuar operatorë ekonomikë!

Pranë Autoritetit Kontraktor U.K.T sh.a është paraqitur ankesë me shkrim nga një operator ekonomik më datë 29.05.2020 në lidhje me specifikimet teknike për procedurën e sipërcituar.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor u morën të gjitha masat për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës i ngarkuar me detyrën për të trajtuar edhe shqyrtuar këtë ankesë.

Pas shqyrtimit të ankesës u konkludua si më poshtë vijon:

Në pikën 5 të DST objekt prokurimi shtohet 1(një) inxhinier gjeoteknik dhe konkretisht:

5.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, të përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2019 – Maj 2020 e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 3 (tre) Inxhinier Ndërtimi (ku një prej tyre të jetë profili Strukturist)
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Elektrik
- 1(një) Inxhinier Elektronik
- 2 (dy) Inxhinier Mekanik
- 1(një) Inxhinier Gjeodet
- 1(një) inxhinier Mjedisi
- 1(një) Arkitekt
- 1(një)Gjeoteknik

Shënim: Prania e një inxhinieri gjeoteknik është parë e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak se objekti që do të ndërtohet ndodhet shumë afër objekteve ekzistuese, kontraktori duhet detyrimisht të ketë si Drejtues Teknik një inxhinier Gjeoteknik, i cili do të monitorojë dhe vlerësojë ndërtimin e pilotave dhe pllakës të themelit në lidhje me shtresat gjeologjike.

Çdo ndryshim i mundshëm në projekt do të shoqërohet edhe me ndryshimin e specifikimeve teknike për t’ju përgjigjur kushteve teknike të projektit dhe zbatimit.

Për çdo ndryshim në zgjedhjen e materialeve do të bëhet miratimi nga projektuesi dhe Investitori me shtesë në specifikimet teknike.

Shtohet kriteri i mëposhtëm:

5.1.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2019 – Maj 2020 e stafi si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik - Drejtim Materialeve
- 1(një) Kimist Mjedisi

Shënim: Së dyti duke qënë se, bëhet fjalë për një godine me funksion publik, ku ka relativisht një numër të madh punonjësish dhe qytetarësh, kontraktori duhet detyrimisht të ketë në stafin e vet një kimist mjedisi i cili duhet të kryejë testimin e të gjitha materialeve që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve.

Kjo me qëllim shmangien e përdorimit të materialeve të dëmshme për qytetarët dhe sigurimin e cilësisë të këtyre materialeve.

Ky person ka detyrë funksionale për të kontrolluar certifikatat e cilësisë të materialeve të përdorura dhe kryerjen e testimeve përkatëse. Specialisti do të shprehet me një relacion në fund të punimeve.

Gjithashtu është e domosdoshme që gjatë realizimit të punimeve pjesë e stafit të jetë edhe një Inxhinier Mekanik - Drejtim Materialeve me qëllim realizimin dhe vënien në punë të pajisjeve dhe makinerive sipas kushteve dhe standarteve të kërkuara.

Nisur nga sa më sipër sqarojmë se Hapja e ofertave **do të jetë** si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 01.07.2020 Ora: 09:00

Vendi:www.app.gov.al , UKT sh.a

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 01.07.2020 Ora: 09:00

Vendi:www.app.gov.al , UKT sh.a

Njësia e Prokurimit: